VENDIM
Nr.900, datë 11.6.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS REMAS, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që trasferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Remas, që qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Remas, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.440, datë 21.5.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Remas, të qarkut të Fierit.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Remas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Remas Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
2-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetit publik	Në pronësi
16-23	Prona që përdoren për realizimin e veprimeve social-kulturore e sportive	Në pronësi
30-41	Varreza publike	Në pronësi
26-29,254-257,261-257	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
236-238	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

276-278	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
89-97	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
24,25,44,49,51	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
239,247	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
139,153,171,176,183,240-246,248-250	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produkte)	Në pronësi